

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, datë, 21.08.2017

Duke marrë parasysh nenin 38 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ligjin Nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, nenin 12 të Rregullores Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Sekretarja e Përgjithshme e MAPL-së, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projekte të organizatave jo-qeveritare në fushën e qeverisjes lokale.

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
2. Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve do të ofrohet nga Buxheti i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, kodi ekonomik 21110 dhe 21200, në kuadër të programit buxhetor të MAPL-së 212.
3. Mjetet e përmendura në pikën 2. të këtij vendimi do të shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës 1. të këtij vendimi përfshinë:
 - 4.1 Teksti i thirrjes publike
 - 4.2 Udhëzimet për aplikantët
 - 4.3 Formularët e aplikimit
 - 4.4 Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve
 - 4.5 Format për raportimin e zbatimit të projektit
5. Formularët e aplikimit referuar pikës 4 të këtij vendimi, janë:
 - 5.1 Forma e përshkrimit të programit apo projektit.

- 5.2 Forma e buxhetit të programit apo projektit
 - 5.3 Forma e deklarimit të mungesës së fondeve të dyfishta.
 - 5.4 Deklaratat e Partneritetit (nëse është e aplikueshme).
 - 5.5 Forma e deklaratës së programeve apo projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike.
 - 5.6 Deklarata për Aktivitetet e kontraktorit e përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë njohur me programin ose projektin dhe pjesëmarrjen e tyre në zbatim (nëse aplikohet).
6. Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të MAPL-së (<http://mapl.rks-gov.net/Home.aspx>).
 7. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, MAPL do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.
 8. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.
 9. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojnë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren për financimin publik të OJQ-ve.
 10. Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve.
 11. MAPL do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.
 12. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave.
 13. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Rozafa Ukimeraj

Sekretare e Përgjithshme

Në kopje:

- Ministri i MAPL-së;
- Shkelqim Jakupi, Udhëheqësi i DIEKP-së/MAPL;
- Divizionit të Buxhetit në MAPL;
- Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Priština, datum, 21.08.2017.

Uzimajući u obzir član 38, Zakona br. 03/L-189 o državnoj administraciji Republike Kosovo, na osnovu člana 17 (stavka 5 i stavka 6) Uredbe br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Zakona br. 05/L-125 o budžetu Republike Kosovo za 2017. godinu, član 12 Uredbe br. 04/2017 o kriterijumima, standardima i procedurama javnog finansiranja NVO-a, generalna sekretarka MALS-a, donosi ovu:

ODLUKU

O objavljivanju javnog poziva za finansijsku podršku projekta nevladinih organizacija (NVO-a) u oblasti lokalne samouprave.

1. Za realizaciju javnog poziva sprovodiće se odbredbe iz Uredbe o kriterijumima, standardima i procedurama javnog finansiranja NVO-a.
2. Javna finansijska podrška za projekte i programe NVO-a, biće ponuđena iz budžeta Ministarstva administracije lokalne samouprave iz ekonomskog koda 21110 i 21200, u okviru budžetskog programa MALS-a, 212.
3. Navedena sredstva u tački 2, ove odluke biće raspodeljene na osnovu javnog poziva za finansiranje NVO projekata, prema dokumentaciji za realizaciju poziva, koja je sastavni deo ove odluke.
4. Potrebna dokumentacija za realizaciju poziva prema tački 1 ove odluke obuhvata:
 - 4.1 Tekst javnog poziva,
 - 4.2 Uputstva za aplikante,
 - 4.3 Formulari za aplikaciju,
 - 4.4 Obrazac za procenu kvaliteta projekta,
 - 4.5 Oblik za izveštavanje realizacije projekta
5. Formulari za aplikaciju pozivaju se na tačku 4 ove odluke i oni su:
 - 5.1 Oblik opisa programa ili projekta.

5.2 Oblik budžeta programa ili projekta


5.3 Oblik deklaracije (izjave) nedostatka dvostrukih fondova.

5.4 Izjave partnerstva (ako je primenljivo).

5.5 Oblik izjave programa ili projekata NVO-a, finansirane iz javnih izvora.

5.6 Izjava za delatnosti navedenog ugovornika u opisu delatnosti projekta koji su poznati sa programom ili projektom i njihovo učešće na realizaciji (ako se aplikuje).

6. Javni poziv i dokumentacija za realizaciju poziva biće objavljeni na potpuni način na internet stranici MALS-a, (<http://mapl.rks-gov.net/Home.aspx>).
7. U saglasnosti sa Uredbom o kriterijumima, standardima i procedurama javnog finansiranja za NVO-e, i uputstva za aplikante, MALS, će stvoriti komisiju za procenu za otvaranje i registrovanje aplikacija kao i utvrđivanje određenih uslova javnog poziva.
8. Komisija za procenu, će vršiti procenu sadržaja aplikacija primljenih projekata koji su uspešno ispunjavali osnovne uslove kako bi bili deo konkurisanja prema stavki 1 ovog člana.
9. Članovi komisije za procenu će raditi u skladu sa određenom procedurom u uputstvima za aplikante i pravilima predviđenim sa Uredbom o javnom finansiranju NVO-a.
10. Nakon donošenja odluke o uspešnim aplikantima, čiji projekti ispunjavaju uslove za finansiranje, rukovodilac institucije donosi odluku za raspodelu finansijskih sredstava za finansiranje NVO, programa ili projekta.
11. MALS, će obavestiti dobitnike za datum potpisivanja ugovora.
12. Odgovoran za sprovođenje ove odluke jeste Odeljenje za evropske integracije i koordinisanje politika.
13. Ova odluka stupa na snagu danom potpisivanja.


Rozafa Ukimeraj

Generalna sekretarka

U kopiji:

- Ministar MALS-a;
- Shkelqim Jakupi, rukovodilac OEIKP-a/MALS;
- Odsek za budžet u MALS-u;
- Arhiva MALS-a.